

VENDIM
Nr. 449, datë 9.7.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 168, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E
NJERIUT, DATË 15.1.2013, PËR ÇËSHTJEN NR. 63756/09, “THEMELI KUNDËR SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e vendimit nr. 168, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama